

URDHËR
Nr. 455, datë 2.8.2023

**PËR PËRDITËSIMIN E URDHËRIT TË MINISTRIT NR. 275, DATË 5.5.2023, “PËR
MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE DHE PËRBËRËSVE TË TJERË, NË
PËRMBAJTJE TË PMB-ve”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar; si dhe të pikës 6.3, të kreut VII, të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe të kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe sipas propozimit të strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, bëhet përditësimi me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

- a) në pjesën C, të shtojcës 1, miratohet për shtim 1 (një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;
- b) rinovohet regjistrimi për 9 (nëntë) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;
- c) zgjaten afatet e regjistrimit për 71 (shtatëdhjetë e një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;
- ç) hiqen 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve të regjistruara.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

1. MIRATOHET PËR SHTIM NË PJESËN C, TË SHTOJCËS 1, LËNDA VEPRUESE ME RREZIK TË ULËT SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1	Calcium carbonate CAS No 471-34-1 CIPAC No 843 Limestone CAS No 1317-65-3 CIPAC No 852	Calcium carbonate	950 g/kg	1 nëntor 2021	31 tetor 2036	Nuk ka

2. RINOVHET REGJISTRIMI (RIREGJISTRIM) PËR:

2.1 LËNDËT VEPRUESE, SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
-----	------------------------------	----------------	-----------	------------------	--------------------	---------------------

	identifikimit					
1.	<i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> EG2348	n.a.	Jo papastërti relevante.	1 korrik 2023	30 qershor 2038	Në vlerësimin e përgjithshëm do të kushtohet vëmendje e veçantë, për: - mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat në vetvete konsiderohen si sensibilizues të mundshëm, duke siguruar që pajisjet e duhura mbrojtëse personale të përfshihen si kusht përdorimi; - sigurimin nga prodhuesi për mirëmbajtjen e rreptë të kushteve mjedisore dhe analizën e kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kufijve të ndotjes mikrobiologjike. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masat e mëposhtme për zbutjen e rrezikut: - duhet të mbahet një periudhë minimale kohore prej 2 ditësh ndërmjet aplikimit të PMB-ve që përmbajnë <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> EG2348 dhe vjeljes së kulturave bujqësore të përdorura për konsum të freskët, përveç rasteve kur të dhënat e disponueshme të matura ose të vlerësuara të mbetjeve tregojnë nivelet e <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> EG2348 nën 105 CFU/gr, siç rekomandohet nga EFSA. Aplikanti duhet të paraqesë informacion shtesë, në lidhje me të dhënat në të paktën një kulturë të ngrënëshme përfaqësuese (d.m.th., në frutat farore dhe perimet solanace gjatë periudhës së frutave), në lidhje me rënien e densitetit të sporeve të qëndrueshme të <i>Bacillus thuringiensis</i>

						subsp. kurstaki EG2348 në pjesët e ngrënëshme të bimëve nga koha e aplikimit të një PMB-je që përmban këtë substancë aktive deri në kohën e vjeljes ose derisa nivelet e gjetura të jenë nën 105 CFU/gr, duke përfshirë të dhënat e qëndrueshmërisë së ruajtjes së mikroorganizmave midis marrjes së mostrave dhe analizës së numërimit të sporeve.
2.	<i>Bacillus amyloliquefaciens</i> shtami QST 713	n.a.	Jo papastërti relevante. Përmbajtja nominale e shtamit <i>Bacillus amyloliquefaciens</i> QST 713 në produktin teknik dhe formulimin është minimumi: 1×10^{12} CFU/kg Maksimumi: 3×10^{13} CFU/kg.	1 korrik 2023	30 qershor 2038	Kur regjistrohen PMB-ja që përmbajnë shtamin <i>Bacillus amyloliquefaciens</i> QST 713 për aplikime me spërkatje në fushë, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e organizmave jo të synuar, përfshirë bletët, duhet të: - autorizohen aplikimet në fushë vetëm në kulturat e palulëzuara ose në prani të barërave të këqija në fushë jashtë periudhës ditore të ushqimit të bletëve; - zbatohen masa për zbutjen e rrezikut që synojnë të reduktojnë lëvizjen në zonat jashtë fushës (p.sh. duke marrë parasysh aplikimin e zonave tampon dhe të zvogëlimit të spërkatjes me sprucatorë). Do të kushtohet vëmendje e veçantë për: - sigurimin nga prodhuesi për mirëmbajtjen e rreptë të kushteve mjedisore dhe analizën e kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kufijve të ndotjes mikrobiologjike; - specifikimet e materialit teknik të prodhuar komercialisht dhe të përdorur në PMB-të; - mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat në vetvete konsiderohen si sensibilizues të mundshëm,

						duke siguruar që pajisjet e duhura mbrojtëse personale të përfshihen si kusht përdorimi.
3.	<i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> SA-12	n.a.	Jo papastërti relevante.	1 korrik 2023	30 qershor 2038	Në vlerësimin e përgjithshëm do të kushtohet vëmendje e veçantë, për: - mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat në vetvete konsiderohen si sensibilizues të mundshëm, duke siguruar që pajisjet e duhura mbrojtëse personale të përfshihen si kusht përdorimi; - sigurimin nga prodhuesi për mirëmbajtjen e rreptë të kushteve mjedisore dhe analizën e kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kufijve të ndotjes mikrobiologjike. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masat e mëposhtme për zbutjen e rrezikut: - një periudhë minimale kohore prej 1 dite duhet të mbahet ndërmjet aplikimit të PMB-ve që përmbajnë <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> SA-12 dhe vjeljes së kulturave bujqësore të përdorura për konsum të freskët, përveç rasteve kur të dhënat e disponueshme të mbetjeve të matura ose të vlerësuara tregojnë nivelet e <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> SA-12 nën 105 CFU/gr, siç rekomandohet nga EFSA. Aplikanti duhet të paraqesë informacion shtesë, në lidhje me të dhënat në të paktën një kulturë të ngrënshme përfaqësuese (d.m.th., në frutat farore dhe domate), në lidhje me rënien e densitetit të sporeve të qëndrueshme të <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i>

						SA-12 në pjesët e ngrënshme të bimëve nga koha e aplikimit të një PMB-je që përmban këtë substancë aktive deri në kohën e vjeljes ose derisa nivelet e gjetura të jenë nën 105 CFU/g, duke përfshirë të dhënat e qëndrueshmërisë së ruajtjes së mikroorganizmave midis marrjes së mostrave dhe analizës së numërimit të sporeve.
4.	<i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> ABTS-351	n.a.	Jo papastërti relevante.	1 korrik 2023	30 qershor 2038	Në vlerësimin e përgjithshëm do të kushtohet vëmendje e veçantë, për: - mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat në vetvete konsiderohen si sensibilizues të mundshëm, duke siguruar që pajisjet e duhura mbrojtëse personale të përfshihen si kusht përdorimi; - sigurimin nga prodhuesi për mirëmbajtjen e rreptë të kushteve mjedisore dhe analizën e kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kufijve të ndotjes mikrobiologjike. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masat e mëposhtme për zbutjen e rrezikut: - një periudhë minimale kohore prej 2 ditësh duhet të mbahet ndërmjet aplikimit të PMB-ve që përmbajnë <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> ABTS-351 dhe vjeljes së kulturave bujqësore të përdorura për konsum të freskët, përveç rasteve kur të dhënat e disponueshme të mbetjeve të matura ose të vlerësuara tregojnë nivelet e <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> ABTS-351 nën 105 CFU/gr, siç rekomandohet

						nga EFSA. Aplikanti duhet të paraqesë informacion shtesë, në lidhje me të dhënat në të paktën një kulturë të ngrënshe përfaqësuese (d.m.th. në lakër dhe domate), në lidhje me rënien e densitetit të sporeve të qëndrueshme të <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> ABTS-351 në pjesët e ngrënshe të bimëve që nga koha e aplikimit të një PMB-je që përmban këtë substancë aktive deri në kohën e vjeljes ose derisa nivelet e gjetura të jenë nën 105 CFU/gr, duke përfshirë të dhënat e qëndrueshmërisë së ruajtjes së mikroorganizmave midis marrjes së mostrave dhe analizës së numërimit të sporeve.
5.	<i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>israelensis</i> shtami AM65-52 Koleksioni i kulturës nr. ATCC 1276	n.a.	Jo papastërti relevante.	1 korrik 2023	30 qershor 2038	Në vlerësimin e përgjithshëm do të kushtohet vëmendje e veçantë, për: - mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat në vetvete konsiderohen si sensibilizues të mundshëm; - sigurimin nga prodhuesi për mirëmbajtjen e rreptë të kushteve mjedisore dhe analizën e kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kufijve të ndotjes mikrobiologjike; - mbrojtjen e pjalmuesve të egër dhe e organizmave ujorë (p.sh. jovertebrorët ujorë nga Dipteret në veçanti) në rast të përdorimit në fushë të hapur. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa specifike për zbutjen e rrezikut, kur është e nevojshme, të tilla si: - pajisjet adekuate mbrojtëse personale për operatorët që

						përdorin PMB që përmbajnë <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>shtami israelensis</i> AM65-52; - në rast të autorizimit të përdorimit në kulturat bujqësore, duhet të mbahet një periudhë minimale prej 3 ditësh ndërmjet aplikimit të PMB-ve që përmbajnë <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>israelensis</i> AM65-52 dhe vjeljes së kulturave bujqësore të përdorura për konsum të freskët, përveç nëse të dhënat e disponueshme të mbetjeve të matura ose të vlerësuara tregojnë nivelet e <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>israelensis</i> AM65-52 nën 105 CFU/gr në vjelje.
6.	<i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>aizawai</i> GC-91	n.a.	Jo papastërti relevante.	1 korrik 2023	30 qershor 2038	Në vlerësimin e përgjithshëm do të kushtohet vëmendje e veçantë, për: - mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat në vetvete konsiderohen si sensibilizues të mundshëm; - sigurimin nga prodhuesi për mirëmbajtjen e rreptë të kushteve mjedisore dhe analizën e kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kufijve të ndotjes mikrobiologjike; - mbrojtjen e pjalmuesve të egër (veçanërisht larvat e bletëve dhe bletët e egra). Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa specifike për zbutjen e rrezikut, kur është e nevojshme. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masat e mëposhtme për zbutjen e rrezikut: - një periudhë minimale kohore prej 2 ditësh duhet të mbahet ndërmjet aplikimit të PMB-ve që përmbajnë <i>Bacillus</i>

						thuringiensis subsp aizawai GC-91 dhe vjeljes së kulturave bujqësore të përdorura për konsum të freskët, përveç nëse të dhënat e disponueshme të mbetjeve të matura ose të vlerësuar tregojnë nivelet e Bacillus thuringiensis subsp. aizawai GC-91 nën 105 CFU/g në vjelje. Aplikanti duhet të paraqesë informacion shtesë në lidhje me të dhënat në të paktën një kulturë të ngrënshme përfaqësuese (d.m.th. frutat farore, rrushi dhe domatet), në lidhje me rënien e densitetit të sporeve të qëndrueshme të Bacillus thuringiensis subsp. aizawai GC-91 në pjesët e ngrënshme të bimëve që nga koha e aplikimit të një PMB-je që përmban këtë substancë aktive deri në kohën e vjeljes ose derisa nivelet e gjetura të jenë nën 105 CFU/gr, duke përfshirë të dhënat e qëndrueshmërisë së ruajtjes së mikroorganizmave midis marrjes së mostrave dhe analizës së numërimit të sporeve.
7.	Bacillus thuringiensis subsp. <i>aizawai</i> shtami ABTS-1857	n.a.	Jo papastërti relevante.	1 korrik 2023	30 qershor 2038	Në vlerësimin e përgjithshëm do të kushtohet vëmendje e veçantë, për: - mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat në vetvete konsiderohen si sensibilizues të mundshëm; - sigurimin nga prodhuesi për mirëmbajtjen e rreptë të kushteve mjedisore dhe analizën e kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kufijve të ndotjes mikrobiologjike; - mbrojtjen e pjalmuesve të egër (veçanërisht larvat e bletëve dhe bletët e egra).

						Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa specifike për zbutjen e rrezikut, kur është e nevojshme. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masat e mëposhtme për zbutjen e rrezikut: - një periudhë minimale kohore prej 2 ditësh duhet të mbahet ndërmjet aplikimit të PMB-ve që përmbajnë <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>Aizawai</i> shtami ABTS-1857 dhe vjeljes së kulturave bujqësore të përdorura për konsum të freskët, përveç nëse të dhënat e disponueshme të mbetjeve të matura ose të vlerësuara tregojnë nivelet e <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>Aizawai</i> soji ABTS-1857 nën 105 CFU/gr në vjelje. Aplikanti duhet të paraqesë informacion shtesë, në lidhje me të dhënat në të paktën një kulturë të ngrënshme përfaqësuese (d.m.th. specia dhe domate), në lidhje me rënien e densitetit të sporeve të qëndrueshme të <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>Aizawai</i> shtami ABTS-1857 në pjesët e ngrënshme të bimëve që nga koha e aplikimit të një PMB-je që përmban këtë substancë aktive deri në kohën e vjeljes ose derisa nivelet e gjetura të jenë nën 105 CFU/gr, duke përfshirë të dhënat e qëndrueshmërisë së ruajtjes së mikroorganizmave midis marrjes së mostrave dhe analizës së numërimit të sporeve.
8.	<i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> SA-11	n.a.	Jo papastërti relevante.	1 korrik 2023	30 qershor 2038	Në vlerësimin e përgjithshëm do të kushtohet vëmendje e veçantë, për: - mbrojtjen e operatorëve dhe punëtorëve, duke marrë parasysh që mikroorganizmat në vetvete

					konsiderohen si sensibilizues të mundshëm; - sigurimin nga prodhuesi për mirëmbajtjen e rreptë të kushteve mjedisore dhe analizën e kontrollit të cilësisë gjatë procesit të prodhimit, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kufijve të ndotjes mikrobiologjike. Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masat e mëposhtme për zbutjen e rrezikut: - një periudhë minimale kohore prej 2 ditësh duhet të mbahet ndërmjet aplikimit të PMB-ve që përmbajnë <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp <i>kurstaki</i> SA-11 dhe vjeljes së kulturave bujqësore të përdorura për konsum të freskët, përveç nëse të dhënat e disponueshme të mbetjeve të matura ose të vlerësuara tregojnë nivelet e <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> SA-11 nën 105 CFU/gr, siç rekomandohet nga EFSA. Aplikanti duhet të paraqesë informacion shtesë, në lidhje me të dhënat në të paktën një kulturë të ngrënshme përfaqësuese (d.m.th. në frutat farore dhe domatet), në lidhje me rënien e densitetit të sporeve të qëndrueshme të <i>Bacillus thuringiensis</i> subsp. <i>kurstaki</i> SA-11 në pjesët e ngrënshme të bimëve nga koha e aplikimit të një PMB-je që përmban këtë substancë aktive deri në kohën e vjeljes ose derisa nivelet e gjetura të jenë nën 105 CFU/gr, duke përfshirë të dhënat e qëndrueshmërisë së ruajtjes së mikroorganizmave midis marrjes së mostrave dhe analizës së numërimit të sporeve.
--	--	--	--	--	--

2.2 LËNDËN VEPRUESE ME RISK TË ULËT SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe numri i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Data e përfundimit	Dispozita specifike
1.	Quartz sand- Rera kuarcit (nuk ka emër të zakonshëm ISO) (1) 7631-86-9 (CAS) (2) 14808-60-7 (CAS) 855 (CIPAC) <i>[Deri më tani ata janë treguar si:</i> CAS No: 14808-60-7 CIPAC No: n.a]	1. Silicon dioxide 2. Quartz	915 g/kg. Silici kristalor i papastër me një diametër grimcash $\leq 10 \mu\text{m}$ është një shqetësim toksikologjik dhe nuk duhet të kalojë një nivel prej 0,1 % të grimcave në materialin teknik.	1 shtator 2023	31 gusht 2038	Kushtet e përdorimit do të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, aty ku është e nevojshme.

3. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

- Deri më 31 janar 2024:

1. Penflufen

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 30 qershor 2024:

1. Pyridalyl

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 31 gusht 2024:

1. Bacillus pumilus QST 2808

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 15 nëntor 2024:

1. S-metolachlor

2. Ethephon

3. Captan

4. Benthiavalicarb

Gjithsej: 4 (katër) lëndë vepruese.

- Deri më 15 dhjetor 2024:

1. Aluminium ammonium sulphate

2. Aluminium silicate

3. Fat distillation residues/mbetjet e distilimit të yndyrës

4. Fatty acids C7 to C20/acidet yndyrore C7 deri në C20

5. Plant oils/rape seed oil/vajra bimore/vaj farash bërsi rrushi

Gjithsej: 5 (pesë) lëndë vepruese.

- Deri më 15 shkurt 2025:

1. Phenmedipham

2. Milbemectin

3. Folpet

4. Formetanate

5. Dimethomorph

6. Metribuzin

Gjithsej: 6 (gjashtë) lëndë vepruese.

- Deri më 31 mars 2025:

1. Halosulfuron-methyl

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 15 prill 2025:

1. Hydrolysed proteins/Proteinat e hidrolizuara

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 15 qershor 2025:

1. Propamocarb

2. Pirimiphos-methyl

3. Fluoxastrobin

Gjithsej: 3 (tre) lëndë vepruese.

- Deri më 15 korrik 2025:

1. Gibberellic acid

2. Gibberellin

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

- Deri më 15 gusht 2025:

1. Prothioconazole

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 31 tetor 2025:

1. Trichoderma asperellum strain T34

2. Cyflumetofen

3. Trichoderma atroviride strain I-1237

4. Helicoverpa armigera nucleopolyhedrovirus

5. Spodoptera littoralis nucleopolyhedrovirus

Gjithsej: 5 (pesë) lëndë vepruese.

- Deri më 30 nëntor 2025:

1. Metam

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 31 dhjetor 2025:

1. Ametoctradin

2. Mandipropamid

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

- Deri më 31 janar 2026:

1. Extract from tea tree/ekstrakt nga pema e çajit

2. Plant oils/spear mint oil/vajra bimore/vaj menteje shtize

3. Plant oils/clove oil/vajra bimore/vaj karafili

Gjithsej: 3 (tre) lëndë vepruese.

- Deri më 28 shkurt 2026:

1. Maltodextrin

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 15 mars 2026:

1. Indolylbutyric acid

2. Flurochloridone

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

- Deri më 15 prill 2026:

1. Boscalid

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 15 maj 2026:

1. Penoxsulam

2. Proquinazid

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

- Deri më 15 qershor 2026:

1. Pyrethrinat

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 15 gusht 2026:

1. Cymoxanil

2. Tebuconazole

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.

- Deri më 31 gusht 2026:

1. Fluopicolide

2. Cycloxydim

3. Hymexazol

4. Clethodim

5. Dazomet

6. Metaldehyde

7. Fenazaquin

8. Diclofop

9. Paclobutrazol

Gjithsej: 9 (nëntë) lëndë vepruese.

- Deri më 30 shtator 2026:

1. Metalaxyl

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

- Deri më 31 tetor 2026:

1. Biflubenazolid

2. Aclonifen

3. Metazachlor

Gjithsej: 3 (tri) lëndë vepruese.

- Deri më 30 nëntor 2026:

1. Acetic acid

2. Ethylene

3. Calcium carbide

4. Iron sulphate/Sulfat hekuri

5. Urea

6. Aluminium phosphide

7. Magnesium phosphide

8. Dodemorph

9. 2,5-Dichlorobenzoic acid methylester

10. Metamitron

11. Sulcotrione

12. Flonicamid (IKI-220)

Gjithsej: 12 (dymbëdhjetë) lëndë vepruese.

Totali: 71 (shtatëdhjetë e një) lëndë vepruese.

4. HIQEN LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1. Ipconazole

Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë Ipconazole brenda datës 31 gusht 2023.

Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë Ipconazole të përfundojë brenda datës 29 shkurt 2024.

2. Dimoxystrobin

Lënda vepruese Dimoxystrobin nuk është e rinovuar.

Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë Dimoxystrobin brenda datës 31 janar 2024.

Heqja nga tregu i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë Dimoxystrobin të përfundojë brenda datës 31 korrik 2024.

Gjithsej: 2 (dy) lëndë vepruese.